REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 743/20
Datë/Datum. 01.10.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr1 i prokurimit	**622-20-4624-2-1-1**
Nr i brendshëm	**622-20-113-211**

Sa i përket tenderit për: Intervenimi në infrastrukturë për rastet e fatkeqësive natyrore dhe eliminimi i deponive ilegale në Komunën e Prizrenit

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

NPN "RENELUAL TAHIRI" shpk

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rruga e Jonit 92/2,Prizren

(Adresa)

Prizren — *20 000*

(Vendi) — *(Kodi postar)*

044/128112 — *N/A*

(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Yll Hoxha

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

renelual_tahiri@hotmail.com

(Adresa elektronike)

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

01.10.2020

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

RENELUAL TAHIRI S.H.P.K.

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) (Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës) (Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Njoftimi për Kontratë me dt. 21.08.2020 Afati i fundit për dorëzimin e ofertave me dt. 02.10.2020 Kërkesa për rishqyrtim:25.09.2020 Vendimi i AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim: 30.09.2020

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po	☐			**Jo**	☐

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po	☐			**Jo**	☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☐ **Jo** ☐

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 27 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Neni 18.9 i RRUOPP
Neni 26.4 i RRUOPP

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar AK-ja me dt. 21.08.2020 keni publikuar tenderin me titull "**Intervenimi në infrastrukturë për rastet e fatkeqësive natyrore dhe eliminimi i deponive ilegale në Komunën e Prizrenit 622-20-113-211**".

AK-ja ka vendosur kërkesa dhe dëshmi dokumentare shumë kundërthënëse dhe me dy kuptimësi, *sepse tek neni 9.1&9.2 i FDT-së ka kërkuar* "**Kërkesa 1. Projektet e natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit të standardeve dhe vlerat e tyre, vlera minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se 2.000.000,00 €**, ndërsa tek dëshmia e kërkuar dokumentare ka kërkuar "**Dëshmia 1 Lista e projekteve te natyrës së kontratës e vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skanuar nga origjinali) për dosjen elektronike, , të dëshmuara me referenca dhe kontrata të cilat dëshmojnë vlerën e shërbimeve dhe natyrën e tyre apo proces verbal të pranimit përfundimtar të shërbimeve.**

Pra te dëshmia fillimisht e ka cekur kontrata të natyrës së kërkuar, ndërsa në fund të dëshmisë e ka cekur vlerën e shërbimeve dhe natyrën e tyre. Kurse tek kërkesa e ka cekur vetëm projekte të natyrës së kontratës.

Nëse shikohet paramasa atëherë vërehet se natyra e këtij aktiviteti të prokurimit dallon me shërbime të kryera sepse në këtë aktivitet të prokurimit parashihen të kryhen punë në shumicën e pozicioneve, pastaj parashihen furnizime gurë te mëdhenj, furnizime me gurë të thyer të fraksioneve të ndryshme, furnizim me gurë zhavori natyral etj., prandaj nëse merret parasysh natyra e këtij aktiviteti të prokurimit është dashur të kërkohen dëshmitë kontrata dhe referenca për punë të ngjashme ku do të hynin, asfaltimi, rehabilitimi, mirëmbajtja, furnizimi, ndërtimi etj. e jo siç e ka cekur AK-ja tek dëshmia e kërkuar dokumentare **të dëshmuara me referenca dhe kontrata të cilat dëshmojnë vlerën e shërbimeve dhe natyrën e tyre apo proces verbal të pranimit përfundimtar të shërbimeve.** Pra AK-ja tek dëshmia e kërkuar dokumentare fillimisht e ka cekur projekte të natyrës së kontratës, e që natyra e kontratës përfshinë aktivitet si punë, furnizime, shërbime etj., ndërsa tek fjalia e fundit e dëshmisë dokumentare ka shënuar se duhet ofruar **dëshmi referenca dhe kontrata të cilat dëshmojnë vlerën e shërbimeve.** Pra edhe brenda dëshmisë së kërkuar dokumentare ka kundërthënie, përveç asaj se dëshmia e kërkuar dokumentare është në kundërshtim me kërkesën, sepse tek kërkesa shkruhet dhe kërkohet vetëm **për Projektet e natyrës së kontratës.**

Gjithashtu edhe titulli i këtij aktiviteti të prokurimit i emërtuar "**Intervenimi në infrastrukturë për rastet e fatkeqësive natyrore dhe eliminimi i deponive ilegale në Komunën e Prizrenit**", nënkupton se ky aktivitet i prokurimit ka të bëjë kryesisht me asfaltim të rrugëve, furnizim etj. prandaj nuk është dashur të cilësohet kjo kontratë si kontratë për shërbime por si kontratë pune dhe ti vendoset numri 5 për të dëshmuar këtë fakt.

Prandaj kërkojmë nga ju që të detyroni AK që ta ndryshon kërkesën dhe dëshminë e kërkuar dokumentare dhe të përpilojë në atë mënyrë që të mundësohet ofertimi dhe ofrimi i dëshmive dokumentare për kontratë të ngjashme, e jo të mbetet e shërbimeve në një vend e në një tjetër e natyrës së kontratës.

Gjithashtu autoriteti kontraktues ka kontrata aktuale të nënshkruara për furnizim me kubëza, me zhavorr, asfaltim etj. dhe nuk është dashur që ti përfshijë në këtë tender edhe këto punë dhe furnizime, sepse janë të pa nevojshme dhe të pa arsyeshme dhe kanë tendencë favorizimi të kompanive të caktuara sikurse edhe në tenderët tjerë, prandaj kërkojmë nga ju që të detyroni AK që të ndryshoj edhe paramasën dhe të largohen furnizimet dhe punët e panevojshme.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe kundërshtimet tona që u cekën më lartë rezulton se autoriteti kontraktues nuk e ka përpiluar dosjen e tenderit në harmoni me nenin 27 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk e ka pasur parasysh as nenin 18.9 të RRUOPP ku shkruan qartë që "*Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk: Kufizon konkurrencën në mesin e OE, ose Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE-ve.*

Pra duke u bazuar në të gjitha faktet që u cekën më lartë shihet tendenca e AK-së për dhënien e kontratës OE të caktuar, pasi që gjitha kërkesat e lartpërmendura i përshtaten kompanive të caktuara.

Ne me dt. 24.08.2020 kemi marrë përgjigje në kërkesën për rishqyrtim ku autoriteti kontraktues ka deklaruar se refuzohet kërkesa për rishqyrtim, mirëpo nuk ka dhënë asnjë përgjigje faktike dhe ligjore në pretendimet tona ankimore. AK-ja në arsyetimin për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim e ka cekur se: *Vlerësimin e caktimit të kategorisë së kontratave nuk e bëni ju si OE por e bën AK duke u mbështetë në rregullat e përcaktuara me LPP.*

Nuk është obligim i OE të na përkujtojnë dhe të na udhëzojnë se a ka qen e arsyeshme zhvillimi i një procedure të caktuar apo jo, Këtë e vlerësojnë strukturat përgjegjëse të Autoritetit Kontraktues, njëherit edhe kërkesat mbi aftësitë teknike dhe profesionale janë të mbështetura dhe të theksuara se duhet të jenë sipas natyrës së kontratës.

Ju sqarojmë se ky arsyetim i AK-së është i pa bazuar pasi që përpilimi i dosjes së tenderit dhe paramasës duhet të bëhet konform të gjitha dispozitave të LPP-së dhe të legjislacionit sekondar dhe jo ti përshtaten kompanive të caktuara siç ka vepruar AK-ja dhe njëkohësisht këto kërkesa kufizojnë konkurrencën në mesin e OE.

Ndërsa sa i përket arsyes së dytë të AK-së për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim ju sqarojmë se AK-ja me këtë veprim të tyre po tregon haptas se këto kërkesa janë favorizuese për kompani të caktuara të cilat do të ofertojnë në këtë aktivitet të prokurimit pasi që përderisa AK-ja e ka cekur se zhvillimin i një procedure të caktuar a është apo jo i arsyeshëm e vlerësojnë strukturat e AK-së, këtu po shihet qartë se vlerësimi nga strukturat e AK-së nuk është bërë në mënyrën e duhur pasi që po shihet qartë tendenca e favorizimit të OE të caktuar pasi që këto kërkesa siç e kemi cekur edhe më lartë janë favorizuese për kompani të caktuara.

Andaj duke u bazuar në faktet e lartpërmendura shihet qartë se arsyetimi i AK-së është i pa bazuar dhe nuk qëndron.

Duke u bazuar në të gjitha ato kërkesa diskriminuese-favorizuese dhe në ato dëshmi të kërkuara, rezulton se në këtë mënyrë nuk mund të arrihet qëllimi i LPP-së, siç parashihet në nenin 1 të këtij ligji, e ku shkruan

qartë: *Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.*

Kërkesat e lartcekura bien në kundërshtim me nenin 7 paragrafi 1, 3, 4 dhe 6 të LPP-së, sepse në këta paragraf parashihet qartë që operatorët ekonomik nuk mund të diskriminohen në asnjë mënyrë dhe në asnjë variant. Prandaj të gjitha kërkesat të cilat i kontestuam më lartë duhet larguar/ndryshuar për të pasur një aktivitet të prokurimit normal dhe për të mos u diskriminuar/favorizuar kompanitë e caktuara.

Kërkesat që u kundërshtuan më lartë, janë shumë favorizuese/diskriminuese dhe të paqarta dhe me dykuptimësi dhe janë në kundërshtim edhe me nenin 26.4 të Rregullave dhe Udhëzuesit operativ për prokurim publik, sepse aty shkruan qartë se "*Gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, AK do ti kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të OE dhe do të formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike*".

Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të lëshojë:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE "**NPN "RENELUAL TAHIRI"**

DETYROHET autoriteti kontraktues që të ndryshoj kërkesat, që u cekën më lartë nga ana jonë dhe pastaj të veprohet konform nenit 53 të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Dëmet materiale akoma nuk janë llogaritur sepse jemi në fazën e njoftimit për kontratë dhe fazën para ofertuese.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*

f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe

g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*